

Republika e Kosovës / Republika e Kosovës
Komuna e Gjakovës / Opština Gjakovica
ANIVARJA DALËSE
IZLAZNE ARHIVA
OUTPUT ARCHIVES
Nr. Inv/Br. Inv. 01-011/01-16154
Data/Datum/Date 28.03.2025
Kuvendi i Komunës së Gjakovës

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA GJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



01 Nr. /2025
Datë: 27.03.2025

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011/04-29365 i datës 30.12.2022, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.03.2025 pas diskutimit lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-00468-26, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-00468-26, me sipërfaqe të parcelës 1633 m² Zona Kadastrale Gjakovë-Qytet, së bashku me objektin me numër të njësisë 468-26-598-0 me sipërfaqe të ndërtesës 241.36 m², në pronësi të Komunës së Gjakovës, me këtë përbërje:

1. z. Durim Halilaj, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës .
2. znj. Adelina Shehu Kola, përfaqësuese nga Ekzekutivi i Komunës.
3. z. Him Zeqa, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
4. znj. Krenare Bushaj, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
5. z. Arbër Lleshi, përfaqësues i sektorit jo qeveritar .

2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Anëtarëve të Komisionit Vlerësues .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit .



Arbëneshja Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës